

ÇELËSI - TEZA 1

**RUBRIKA 3
OPINIONE LIGJORE (60 pikë)**

1. OPINION LIGJOR NË FUSHËN PENALE (20 pikë)

Më datë 15 janar 2025, shtetasja C.D., administratore e një shoqërie tregtare, e cila ushtron aktivitet ndërtues me seli në Vlorë, paraqet një kërkesë zyrtare pranë Drejtorisë Rajonale të Mjedisit për pajisjen me leje mjedisore për një projekt turistik në zonën e Radhimës. Pas shqyrtimit fillestar, më datë 10 shkurt 2025, specialistët e institucionit konstatojnë mangësi në planin e trajtimit të mbetjeve, duke pezulluar procedurën.

Më datë 20 shkurt 2025, shtetasi A.B., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale, e thërret C.D. në zyrën e tij në qytetin e Vlorës. Gjatë bisedës, ai i bën të qartë se plotësimi i dokumentacionit mund të zgjasë me muaj, duke rrezikuar investimin e nisur. Ai i propozon asaj që, në këmbim të miratimit të menjëhershëm të lejes, ata të konsumojnë një fundjavë së bashku në një resort në qytetin e Korçës.

Më datë 6 mars 2025, të dy personat regjistrohen në një hotel në qytetin e Korçës, ku konsumohet favori seksual. Menjëherë pas rikthimit në detyrë, më datë 9 mars 2025, shtetasi A.B. nxjerr aktin administrativ për miratimin e lejes mjedisore, duke udhëzuar stafin teknik të mos vijojë me kërkesat për plotësim dokumentacioni.

Pyetje:

1. "A përfshihet përfitimi me natyrë seksuale brenda nocionit ligjor të 'përfitimit të parregullt', si element i figurës së veprës penale të korrupsionit, sipas legjislacionit penal në fuqi dhe standardeve ndërkombëtare? Cili është raporti me veprën penale të "Marrëdhënie seksuale duke shpërdoruar detyrën". (20 pikë)

Zgjidhje:

Në çështjen konkrete shtrohet për analizë nëse favori seksual i kërkuar nga funksionari publik përbën apo jo përfitim të parregullt në kuptim të veprës penale të korrupsionit dhe cili është raporti i kësaj figure me veprën penale marrëdhënie seksuale duke shpërdoruar detyrën për zgjidhjen e rastit duhen analizuar elementët objektivë dhe subjektivë të figurave penale përkatëse, si dhe standardët ndërkombëtare të së drejtës penale dhe instrumentet ndërkombëtare kundër korrupsionit.

Analiza juridike

Nga faktet rezulton se shtetasi CD administratori i një shoqërie tregtare kishte paraqitur kërkesë për pajisje me leje mjedisore dhe procedura administrative ishte pezulluar për mangësi dokumentacioni, më pas drejtori rajonal AB në cilësinë e funksionarit publik kompetent për trajtimin e procedurës, i ka bërë të ditur personit CD se procesi mund të zgjasë me 6 muaj duke i krijuar kështu një situatë presioni ekonomik dhe administrativ. Në vijim, ai i ka propozuar kalimin e një fundjave së bashku në këmbim të favoreve seksuale, ndërsa pas realizimit të tyre, ai ka urdhëruar vijimin e procedurës së miratimit të lejes për personin CD edhe pse me mangësi në dokumentacioni.

Së pari, duhet analizuar figura e korrupsionit pasiv të funksionarit publik.

Sipas Kodit penal kjo veprë konsumohet kur funksionari publik kërkon, merr ose pranon premtim për një përfitim të parregullt për të kryer ose moskryer një veprim që lidhet me funksionin e tij publik. Në rastin konkret plotësohen të gjithë elementët e figurës së veprës penale.

- 1. Subjekti aktiv është funksionar publik*
- 2. Ekziston kërkitimi i një përfitimi*
- 3. Përfitimi lidhet drejtpërdrejtë me ushtrimin e një kompetence administrative.*
- 4. Ekziston lidhje shkakësore midis favorizimit administrativ dhe përfitimit të kërkuar.*

Në lidhje me nocionin përfitimi i parregullt sipas standardeve ndërkombëtare dhe Konventës së OKB kundër korrupsionit, pranojnë se ky nocion nuk kufizohet vetëm me përfitim pasuror ose monetar, përfitimi mund të jetë edhe jopasuror përsa kohë që krijon avantazhin personal për funksionarin. Ndaj edhe favori seksual përfshihet në konceptin e përfitimit të parregullt dhe hyn brenda objektit material të korrupsionit.

Ne rastin konkret, personi AB përdor pozitën e tij publike dhe devijon në ushtrimin e detyrës së tij duke e vënë funksionin në shërbim të interesit të tij privat.

Së dyti, sjellja e AB mund të kualifikohet edhe si marrëdhënie seksuale duke shpërdoruar detyrën. Kjo figurë penale realizohet kur personi duke shfrytëzuar pozitën e tij autoritare apo marrëdhënien e varësisë që buron nga funksioni e shfrytëzon për të siguruar marrëdhënie apo lidhje seksuale.

Mund të themi se korrupsioni mbron integritetin, paanshmërinë dhe ligjshmërinë e administratës publike. Ndërsa marrëdhënia seksuale duke shpërdoruar detyrën mbron lirinë dhe autonominë seksuale të individit nga abuzimi me pushtetin pasi marrëdhënia nuk paraqitet si një raport i lirë dhe i barabartë, por si një marrëdhënie që vjen si rezultat i shpërdorimit të autoritetit publik. Për rrjedhojë e njëjta sjellje mund të cenojë njëkohësisht dy interesa juridikë të ndryshme dhe të sjellë përgjegjësi penale për të dyja veprat penale, si në rastin konkret për personin AB.

2

2. OPINION LIGJOR NË FUSHËN CIVILE (20 pikë)

Përpara Jush me cilësinë e ndihmësit ligjor/këshilltarit ligjor të gjyqtarit, është paraqitur për përgatitjen e një opinionit ligjor për nevoja të gjykimit, situata ligjore e mëposhtme:

I. Rrethanat e faktit

Paditësi A i është drejtuar gjykatës me padi ndaj të paditurit B me objekt “Lirim dhe dorëzim sendi” bazuar në nenin 296 të KC. Sendi objekt rivendikimi është një apartament banimi, pronësinë e të cilit paditësi A e ka fituar përmes kontratës së privatizimit të lidhur me ish Ndërmarrjen Komunale Banesa në bazë të ligjit “Për privatizimin e banesave shtetërore”. Nga hetimi gjyqësor rezultoi e provuar se kontrata e privatizimit është lidhur në kundërshtim me ligjin „Për privatizimin e banesave shtetërore“.

II. Çështjet që shtrohen për zgjidhje:

1. Në pozicionin e ndihmësit apo këshilltarit ligjor a do e këshillonit gjyqtarin e çështjes që të merrte kryesisht në shqyrtim pavlefshmërinë e kontratës së privatizimit, pavarësisht faktit se pavlefshmëria e saj nuk është pretenduar nga pala e paditur në gjykim? **(5 pikë)**
2. Nese po, a do të këshillonit gjyqtarin e çështjes që në vendimmarrjen përkatëse të zgjidhte pasojat e pavlefshmërisë së kontratës së privatizimit të lidhur mes paditësit A dhe ish Ndërmarrjes Komunale Banesa? **(5 pikë)**
3. Jepni mendimin tuaj të arsyetuar për opinionin që do përgatisni për gjyqtarin në lidhje me zgjidhjen e çështjes në themel. **(10 pikë)**

Zgjidhje:

Kazusi civile

1. Referuar rrethanave të parashtruara rezulton se në rastin në shqyrtim jemi përpara një padie rivendikimi, të parashikuar në nenin 296 të Kodit Civil. Padia e rivendikimit është padia e pronarit jo posedues ndaj poseduesit jo pronar. Kjo padi ka për qëllim: a) njohjen e së drejtës së pronësisë të paditësit mbi sendin e rivendikuar dhe b) detyrimin e të paditurit t'i kthejë paditësit sendin e rivendikuar. Njohja e pronësisë së paditësit është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërimit të paditësit dhe për këtë arsye pala paditëse ka barrën e provës për të provuar të drejtën e pronësisë, veçanërisht mënyrën e fitimit të saj. Duke qenë se sendi objekt gjykimi pretendohet se është fituar me anë të kontratës së privatizimit rezulton se kontrata e privatizimit përbën një ndër aktet kryesore që duhet të shqyrtohet nga ana e gjykatës me qëllim vlerësimin e bazueshmërisë së pretendimeve të palës paditëse. Nga ana tjetër, në rrethanat e faktit parashtrohet se kontrata është lidhur në kundërshtim me ligjin, çka do të thotë se potencialisht jemi në kushtet e pavlefshmërisë

absolute sipas nenit 92, germa "a", të Kodit Civil, i cili parashikon se: "Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: a) vijnë në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit". Një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm konsiderohet se nuk ka ekzistuar asnjëherë dhe nuk mund të sjellë pasoja juridike pavarësisht nga afatet e kaluara ose veprimet e mëvonshme të palëve. Veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë. Për këto arsye, referuar edhe praktikës unifikuese, në kushtet e pavlefshmërisë absolute, pavlefshmëria mund të shqyrtohet edhe kryesisht nga gjykata, pavarësisht kërimit të palëve.

2. Zgjidhja e pasojave të pavlefshmërisë së një veprimi juridik duhet parë në raport me ndërgjyqësinë dhe palët që cenohen apo përfitojnë nga konstatimi i pavlefshmërisë. Në rastin në shqyrtim rezulton se Ndërmarrja Komunale Banesa nuk është pjesë e gjykimit dhe rrjedhimisht gjykata nuk mund të zgjidhë pasojat e kontratës së privatizimit për sa kohë një prej palëve në kontratë nuk është pjesë e gjykimit. Nga ana tjetër, rezulton se vetë palët në gjykim nuk kanë kërkuar zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë dhe gjykata duhet të shprehet vetëm për atë që kërkohet dhe për atë që kërkohet. Referuar edhe praktikës unifikuese, kur gjykata gjate shqyrtimit të çështjes, konstaton se një veprim juridik është absolutisht i pavlefshëm, ajo nuk jep vendim për deklarimin e tij të pavlefshëm, por kufizohet vetëm në vërtetimin e pavlefshmërisë dhe, duke u nisur nga kjo, zgjidh konfliktin e palëve ndërgjyqese rreth marrëdhënies juridike përkatëse që është në gjykim.
3. Në lidhje me zgjidhjen në themel të çështjes, pavarësisht faktit se gjykata nuk mund të shprehet për rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë për shkak të arsyeve të parashtruara në përgjigje të pyetjes Nr.2, vlerësohet se pavlefshmëria duhet mbajtur parasysh me qëllim vlerësimin e bazueshmërisë së kërimit të palës paditëse. Sikurse u parashtrua edhe më sipër njohja e pronësisë së paditësit është kusht i domosdoshëm për pranimin e kërimit të paditësit dhe për këtë arsye pala paditëse ka barrën e provës për të provuar të drejtën e pronësisë, veçanërisht mënyrën e fitimit të saj. Nëse ky kusht nuk plotësohet në gjykim për shkak të pavlefshmërisë së kontratës së privatizimit do të thotë se kërkimi i paditësit për lirim dhe dorëzimin e sendit është i pabazuar pasi ai nuk legjitimohet në ngritjen e padisë dhe rrjedhimisht padia duhet të rrëzohet. I takon paditësit më pas të vlerësojë mundësitë për të paraqitur një padi të re dhe për të kërkuar njohjen e pronësisë sipas formave të tjera që ka parashikuar Kodi Civil nëse plotësohen kushtet e ndonjë prej mënyrave të tjera, përfshirë parashkrimin fitues.

4

3. OPINION LIGJOR NË FUSHËN ADMINISTRATIVE (20 pikë)

I. Rrethanat e çështjes

1. Paditësi A.K. është oficer karriere në Forcat e Armatosura të RSH dhe mban gradën ushtarake nënkolonel. Në vitin 2017 ai mori pjesë në procedurën e vlerësimit për përparim në gradën “Kolonel”. Nga Komisioni i Lartë i Karrierës (KLK) ai u vlerësua me 78.295 pikë dhe u rendit në vendin e 18-të në listën e meritës.
2. Duke mos qenë dakord me rezultatin, A.K. paraqiti ankim administrativ pranë Ministrisë së Mbrojtjes. Ankesa u rrëzua me arsyetimin se vlerësimi për (i) raportet e vlerësimit vjetor të punës; (ii) detyrat funksionale; (iii) prezantimin e intervistën, ishte bërë në përputhje me nenet 29, 31 dhe 33 të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KLK-së.
3. Më pas A.K. iu drejtua gjykatës administrative me padi, duke kërkuar: shfuqizimin e njoftimit të vlerësimit të KLK-së; shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave; detyrimin e Ministrisë së Mbrojtjes për rivlerësim dhe rilistim sipas meritës; nxjerrjen e akteve administrative për dhënien e gradës “Kolonel”; pagimin e diferencave të pagës.
4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e rrëzoi padinë. Ajo arsyetoi se, ndonëse vlerësimi për përparimin në gradë dhe dhënia e gradave ushtarake përbëjnë veprimtari administrative, kontrolli gjyqësor shtrihet vetëm mbi procedurën dhe jo mbi vlerësimin në themel. Gjykata vlerësoi gjithashtu se ligji nr. 59/2014 nuk parashikon shprehimisht të drejtën e padisë për kundërshtimin gjyqësor të vlerësimit të komisioneve të karrierës në procedurat e gradimit dhe se, ndryshe nga ligji i mëparshëm nr. 9171/2004, një shprehimisht padi vetëm për raste të tjera, si dalja në rezervë ose lirim nga shërbimi. Për rrjedhojë, sipas saj, kjo mosmarrëveshje nuk gëzon mbrojtje gjyqësore në themel. Gjykata Administrative e Apelit e la në fuqi këtë vendim.
5. Në rekurs, A.K. pretendoi se: kishte ezauruar ankimin administrativ dhe legjitimohej t'i drejtohej gjykatës; gjykatat e faktit kishin interpretuar gabim ligjin dhe i kishin mohuar aksesin në drejtësi; gjykatat nuk kishin shqyrtuar pretendimet për zbatimin e neneve 29, 31 dhe 33 të rregullores; pikëzimi i tij për disa rubrika ishte ulur ndjeshëm krahasuar me vitin pararendës, ndonëse mbështetej mbi të dhëna dhe elemente të njëjta ose më të favorshme; gjykata duhej të verifikonte nëse diskrecioni administrativ ishte ushtruar sipas ligjit, me arsyetim të mjaftueshëm dhe pa arbitraritet.

II. Çështjet që duhen analizuar

1. Analizoni nëse është i drejtë qëndrimi i gjykatave të faktit se mosmarrëveshja e ngritur nga A.K., megjithëse lidhet me veprimtari administrative, nuk gëzon mbrojtje gjyqësore në themel. (5 pikë)
2. Analizoni marrëdhënien ndërmjet ligjit nr. 49/2012, Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjit nr. 59/2014 për sa i përket kontrollit gjyqësor të veprimtarisë së organeve të karrierës në procedurat e gradimit, duke përfshirë edhe çështjen nëse mungesa e një

5

parashikimi të shprehur për padi në ligjin e posaçëm përjashton mbrojtjen gjyqësore. (6 pikë)

3. Analizoni kufijtë e kontrollit gjyqësor mbi veprimtarinë vlerësuese të organeve të karrierës dhe vlerësoni nëse gjykatat e faktit i kanë trajtuar në mënyrë të plotë, të mjaftueshme dhe jo kontradiktore pretendimet e A.K. në lidhje me zbatimin e neneve 29, 31 dhe 33 të rregullores, arsyetimin e vendimmarrjes dhe mospërputhjet e pretenduara në pikëzimin ndër vite. (4 pikë)

4. Duke u mbështetur në faktet e çështjes, pretendimet e palëve dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm, analizoni zgjidhjen që duhet t'i jepet mosmarrëveshjes në gjykimin në Gjykatën e Lartë. (5 pikë)

Përgjigje model – Teza 1, e drejtë administrative

Çështja 1 (5 pikë)

Qëndrimi i gjykatave të faktit se mosmarrëveshja nuk gëzon mbrojtje gjyqësore në themel **nuk është i drejtë**.

Vlerësimi i një ushtaraku nga Komisioni i Lartë i Karrierës për përparim në gradë përbën **veprimtari administrative**, sepse kryhet nga një organ i krijuar në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, në ushtrim të kompetencave publike dhe me pasoja të drejtpërdrejta mbi karrierën, statusin profesional dhe interesat pasurorë të ushtarakut.

Fakti që kjo veprimtari ka karakter vlerësues dhe përfshin elemente diskrecioni nuk e përjashton atë nga kontrolli gjyqësor. Përkundrazi, sipas nenit 42 të Kushtetutës, çdo subjekt ka të drejtë të kërkojë mbrojtje gjyqësore kur pretendon cenimin e një të drejte ose interesi të ligjshëm. Në rastin konkret, A.K. pretendonte se ishte cenuar në të drejtën për zhvillim të karrierës, në pritshmërinë për përparim në gradë dhe në interesat financiare që rridhnin prej saj.

Gjykatat e faktit kanë rënë në një kontradiktë. Nga njëra anë pranuan se veprimtaria e KLK-së është veprimtari administrative dhe se mund të kontrollohet procedura, nga ana tjetër arritën në përfundimin se mosmarrëveshja nuk gëzon mbrojtje gjyqësore në themel. Ky arsyetim është i pasaktë, sepse gjykata administrative nuk kufizohet vetëm në kontroll formal të ekzistencës së procedurës, por duhet të verifikojë nëse organi publik ka vepruar brenda kompetencës, sipas procedurës së rregullt, mbi bazën e kriterëve të paracaktuara, me arsyetim të mjaftueshëm dhe pa arbitraritet.

Në këtë kuptim, përgjigjja e saktë është se padia e A.K. ishte e gjykueshme. Gjykata nuk kishte të drejtë ta trajtonte vlerësimin e KLK-së si të imunizuar nga kontrolli gjyqësor. Ajo duhej të hynte në shqyrtimin e ligjshmërisë së veprimtarisë administrative, pa zëvendësuar vetë vlerësimin

6

Provimi i pranimit të kandidatëve për ndihmës ligjor - 19 maj 2026

profesional të organit kompetent. Teza vetë parashtron se paditësi kishte kërkuar shfuqizimin e njoftimit të vlerësimit, shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, rivlerësim, rilistim dhe pasoja të tjera pasuese.

Çështja 2 (6 pike)

Ligji nr. 59/2014 është ligji i posaçëm material që rregullon karrierën ushtarake, përfshirë përparimin në gradë, organet kompetente, kriteret dhe ankimin administrativ. Neni 22 i tij përcakton se komisionet e karrierës janë autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e përparimit në gradë, ndërsa neni 28 njih të drejtën e ankimit administrativ kundër vlerësimit të KLK-së. Në tezë theksohet gjithashtu se neni 30 njih shprehimisht të drejtën e padisë për daljen në rezervë ose lirim nga shërbimi.

Megjithatë, mungesa në ligjin nr. 59/2014 e një dispozite të shprehur që parashikon padinë gjyqësore kundër vlerësimit për gradim **nuk mund të interpretohet si përjashtim i kontrollit gjyqësor**. Një përjashtim i tillë do të duhej të ishte i qartë, i shprehur dhe në çdo rast në përputhje me Kushtetutën. Nuk mund të nxirret me interpretim heshtës përjashtimi i aksesit në gjykatë.

Ligji nr. 49/2012 ka funksion procedural dhe juridiksional. Ai përcakton se çfarë është organ publik, kush legjitimohet të ngrejë padi dhe cilat janë detyrat e gjykatës administrative në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Sipas nenit 2 pika 6, organet e Forcave të Armatosura konsiderohen organe publike kur ushtrojnë funksione administrative. Sipas neneve 15 dhe 16, padi mund të ngrejë subjekti që pretendon cenimin e një të drejte apo interesi të ligjshëm nga veprimtaria administrative.

Kodi i Procedurave Administrative, nga ana tjetër, vendos parimet e përgjithshme të veprimtarisë administrative: procedurë të rregullt, ushtrim të ligjshëm të diskrecionit, mosarbitraritet, arsyetim dhe nënshtrim të veprimtarisë administrative ndaj kontrollit gjyqësor. Neni 21 i KPA-së është veçanërisht i rëndësishëm, sepse sanksionon parimin se veprimtaria administrative i nënshtrohet kontrollit gjyqësor.

Prandaj, ligji nr. 59/2014 nuk mund të lexohet i izoluar. Ai duhet interpretuar në harmoni me Kushtetutën, ligjin nr. 49/2012 dhe KPA-në. Ligji i posaçëm përcakton organin dhe procedurën e vlerësimit, por nuk mund të zhdukë garancinë kushtetuese të kontrollit gjyqësor mbi ligjshmërinë e veprimtarisë administrative.

Cështja 3 (4 pikë)

Kontrolli gjyqësor mbi veprimtarinë e organeve të karrierës nuk do të thotë që gjykata të zëvendësojë Komisionin e Lartë të Karrierës në vlerësimin profesional të kandidatit. Gjykata nuk

7

Provimi i pranimit të kandidatëve për ndihmës ligjor - 19 maj 2026

mund të vendosë vetë sa pikë duhet të marrë kandidati në intervistë, në detyrat funksionale apo në raportet vjetore, dhe as nuk mund të marrë drejtpërdrejt rolin e organit të gradimit.

Por gjykata ka detyrim të kontrollojë ligjshmërinë e procesit vlerësues. Ky kontroll përfshin verifikimin nëse:

1. organi ka qenë kompetent;
2. janë respektuar procedurat e parashikuara nga ligji nr. 59/2014 dhe rregullorja nr. 666/2016;
3. janë zbatuar kriteret e paracaktuara në nenet 29, 31 dhe 33 të rregullores;
4. vendimmarrja është arsyetuar në mënyrë të mjaftueshme;
5. pikëzimi ka qenë i kontrollueshëm dhe jo arbitrar;
6. janë trajtuar pretendimet konkrete të subjektit;
7. ka ose jo mospërputhje të pajustificuara ndërmjet vlerësimeve të viteve të ndryshme;
8. është respektuar parimi i barazisë dhe meritokracisë.

Në rastin konkret, A.K. kishte ngritur pretendime konkrete dhe jo thjesht pakënaqësi subjektive ndaj rezultatit. Ai pretendonte se vlerësimet vjetore ishin “shkëlqyeshëm”, se në vitin 2017 kishte marrë pikë më të ulëta se në vitin 2016 për rubrika që mbështeteshin në të dhëna të njëjta ose më të favorshme, se detyrat funksionale kishin ardhur në rritje dhe se intervista ishte pikëzuar në mënyrë të pajustificuar më ulët. Teza e provimit i identifikon pikërisht këto pretendime si çështje që duhen analizuar nga kandidati.

Gjykatat e faktit nuk i trajtuan këto pretendime në mënyrë të plotë dhe të mjaftueshme. Ato u mjaftuan me konstatimin se vlerësimi është në diskrecionin e organit administrativ dhe se procedura rezultonte e respektuar. Ky arsyetim ishte i pamjaftueshëm, sepse nuk ballafaqoi konkretisht pretendimet e paditësit me nenet 29, 31 dhe 33 të rregullores.

Gjykata Administrative e Apelit, në veçanti, duhej të verifikonte konkretisht për secilën rubrikë:

- për raportet vjetore: nëse pikëzimi i dhënë ishte i pajtueshëm me vlerësimet “shkëlqyeshëm”;
- për detyrat funksionale: nëse vlerësimi më i ulët krahasuar me vitin paraardhës kishte shpjegim objektiv;
- për intervistën/prezantimin: nëse ulja e ndjeshme e pikëve ishte e arsyetuar dhe e kontrollueshme;
- për diferencat ndër vite: nëse administrata kishte dhënë arsye të qarta për ndryshimin e pikëzimit mbi të dhëna të njëjta ose të ngjashme.

Për rrjedhojë, kufiri i saktë është ky:

gjykata nuk bën rivlerësim profesional në vend të KLK-së, por kontrollon nëse vlerësimi i

KLK-së është kryer sipas ligjit, sipas kritereve të paracaktuara, me arsyetim të mjaftueshëm dhe pa arbitraritet.

Ceshtja 4 (5 pikë)

Zgjidhja e drejtë në Gjykatën e Lartë është: **prishja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimi i çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.**

Rekursi i A.K. duhej pranuar pjesërisht, sepse përmbante shkaqe që lidheshin me zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural, si dhe me cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor. Gjykatat e faktit kishin interpretuar gabim marrëdhënien ndërmjet ligjit të posaçëm nr. 59/2014 dhe garancive të përgjithshme të kontrollit gjyqësor të veprimtarisë administrative.

Megjithatë, Gjykata e Lartë nuk duhet të vendoste vetë për dhënien e gradës “Kolonel”, as të urdhëronte drejtpërdrejt akordimin e diferencave të pagës. Këto kërtime janë pasuese dhe varen nga rezultati i rivlerësimit administrativ. Gjykata nuk mund të zëvendësojë organin kompetent në vlerësimin profesional dhe në pikëzimin e kandidatit.

Zgjidhja e drejtë është kthimi për rigjykim, me detyrimin që Gjykata Administrative e Apelit të:

1. pranojë se çështja gëzon mbrojtje gjyqësore;
2. përcaktojë drejt kufijtë e kontrollit gjyqësor;
3. verifikojë konkretisht zbatimin e neneve 29, 31 dhe 33 të rregullores;
4. shqyrtojë pretendimet për diferencat e pikëzimit ndër vite;
5. kërkojë dhe vlerësojë arsyetimin e organit administrativ për çdo rubrikë të kontestuar;
6. vlerësojë nëse ka pasur arbitraritet, mungesë transparence, shkelje të barazisë ose devijim nga qëllimi i ligjit;
7. japë një vendim të arsyetuar, të plotë dhe të kontrollueshëm.

Nëse në rigjykim rezulton se vlerësimi administrativ është i paligjshëm, gjykata mund të shfuqizojë aktet e kundërshtuara dhe të detyrojë organin kompetent të bëjë rivlerësimin sipas ligjit. Por gjykata nuk duhet të caktojë vetë pikët, as të vendosë drejtpërdrejt gradimin, përveçse kur nga ligji dhe faktet nuk mbetet asnjë hapësirë vlerësimi për administratën, gjë që në këtë çështje nuk rezulton.

Në vendimin ndihmës, Kolegji Administrativ vendosi pikërisht prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim me tjetër trup gjykues.

Konkluzioni përfundimtar i çelësit

Përgjigjja e saktë duhet të arrijë në këto përfundime:

9

Provimi i pranimit të kandidatëve për ndihmës ligjor - 19 maj 2026

1. **Mosmarrëveshja gëzon mbrojtje gjyqësore**, sepse lidhet me veprimtari administrative që prek të drejta dhe interesa të ligjshme të ushtarakut.
2. **Mungesa e një parashikimi të shprehur për padi në ligjin nr. 59/2014 nuk e përjashton kontrollin gjyqësor**, për sa kohë nuk ka një dispozitë të qartë për mosankimueshmëri dhe për sa kohë zbatohen garancitë kushtetuese, ligji nr. 49/2012 dhe KPA.
3. **Diskrecioni i Komisionit të Lartë të Karrierës nuk është i pakontrollueshëm**. Gjykata kontrollon ligjshmërinë, procedurën, kriteret, arsyetimin, mosarbitraritetin dhe respektimin e meritokracisë, por nuk zëvendëson organin administrativ në vlerësimin profesional.
4. **Gjykatat e faktit kanë gabuar**, sepse nuk i kanë dhënë përgjigje të plotë pretendimeve për zbatimin e neneve 29, 31 dhe 33 të rregullores, për mospërputhjet në pikëzim ndër vite dhe për arsyetimin e vendimmarrjes.
5. **Zgjidhja në Gjykatën e Lartë është prishja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe kthimi i çështjes për rigjykim me tjetër trup gjykues**, jo dhënia e drejtpërdrejtë e gradës “Kolonel” nga Gjykata e Lartë.

Sushije Coloni
[Signature]

Nurita Pajze
[Signature]

Jeza [Signature]
[Signature]
10/